

# Kryqi i Kuq – Shërbimi për shkrim

Ndihmë për të kuptuar letërkëmbimin në gjuhën gjermane

## Çka ofron Shërbimi për shkrim

Vullnetarët e Kryqit të Kuq me kënaqësi iu ndihmojnë për ta mbajtur letërkëmbimin me institucionet dhe me autoritetet. Ata iu ndihmojnë në:

- Hartimin e shkresave
- Plotësimin e formularëve
- Leximin korrekt të teksteve dhe shkresave
- Formulimin e fletëlargimeve dhe reklami-meve
- Përgaditjen e dokume teve për punë

## Kujt i dedikohet Shërbimi për shkrim i Kryqit të Kuq?

- Keni vështirësi me gjuhën letrare gjermane?
- Doni të jeni i sigurt nëse e keni kuptuar drejt shkresën zyrtare?
- Keni nevojë për ndihmë për t'i plotësuar formularët zyrtarë?
- Apo iu nevojitet ndihma për të mbajtur letërkëmbimin?

Nëse jeni përgjegjur me «po» në një apo më shumë pyetje, Shërbimi për shkrim mund të jetë në shërbimin tuaj apo të të afërmëve tuaj.

Në iu ndihmojmë për ta shkruar një shkresë, për ta plotësuar një formular ose për çështjet e përgjithshme të të kuptuarit!

## Si funksionon Shërbimi për shkrim?

Bashkëpunëtorët e Shërbimit për shkrim në kohën e përcaktuar janë për juve këtu!

Ju mund të vini te ne pa paralajmërim dhe paasnjë komplikim. ose na telefononi pa ndonjë detyrim. Adresën e vendeve dhe numrat e telefonit të shërbimit për shkrim i merrni në faqën e fundit.

Nëse është e nevojshme për çështje konkrete do të njoftoheni për pikëtakimet tjera.

Shërbimit për shkrim të Kryqit të Kuq, për seancë e paguani shumë prej 5 fr. Paraqitja nuk është e nevojshme. Infrastruktura e nevojshme si: kompjuteri, shtypësi dhe letra ofrohen nga Kryqi i Kuq Zviceran i Aargaut. Të dhënat tuaja personale si edhe të gjitha informatat tjera do të trajtohen në mënyrë shumë të besueshme.

Ne jemi të gëzuar që mund t'ua ofrojmë këtë shërbim!

Nëse ju ndjeheni të pasigurtë për të shkruar në gjuhën letrare gjermane apo keni vështirësi për të bërë një shkresë pa gabime, bashkëpunëtorët tonë vullnetarë iu ndihmojnë për ta mbajtur letërkëmbimin tuaj privat apo zyrtar.

Albanisch, März 2017

